

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
( PAS PROCESIT TË ANKIMIT)**

Për: “SI.SI-AL” sh.p.k me Nr.Nipti:K72117030P me adresë: Tiranë, KASHAR Autostrada Tiranë-Durrës, km 4, Përballë BMW-së.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, prokurim me mjete elektronike – shërbime me numër REF-00773-07-12-2021.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim Vijezi dhe Vendosje Tabelash”.

**Fondi limit 5,960,510** (pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**

Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Tirana Parking, miratuar me V.K.B. Nr.172 datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak të Tiranës “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: deri në 31.12.2021 duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **21.09.2021, ora 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

**Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë ky ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

**1.Operatori ekonomik “SI.SI-AL ” sh.p.k**

**K72117030P**

Çmimi total i ofertës është **5,779,680** (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

1.Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “ **SI.SI-AL” sh.p.k**

Çmimi total i ofertës është **5,779,680** (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- I plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DST. Është paraqitur grafiku i lëvrimit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu X neni 82, pika 3, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik . **“SI.SI-AL” sh.p.k është në përputhje** me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar **si ofertë të vlefshme**.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” vlerëson në bazë të formulës së parashikuar në dokumentat e tenderit nëse oferta është apo jo anomalisht e ulët.

Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në VKM Nr.285 dt 19.05.2021 Kreu X, Neni 82, pika 4 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nga shqyrtimi që ju është bërë dokumentacionit të operatorit ekonomik të paraqitur rezultoi fitues nga **1(një)** operator ekonomik dhe rrjedhimisht përdoret formula e mëposhtme:

*“Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak** oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.”*

#### **Operatori ekonomik. “SI.SI-AL” sh.p.k**

Ka paraqitur ofertë ekonomike në shumën prej **5,779,680** (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**

**Fondi limit** = është **5,960,510** (pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e dhjetë) **lekë pa TVSH**

**“SI.SI-AL” sh.p.k** me ofertë ekonomike prej **5,779,680** (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**

**75% i Fondit Limit** = **75% x 5,960,510 = 4,470,383** (katër milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) **Lekë pa TVSH**.

Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezulton se oferta e **“SI.SI-AL sh.p.k** nuk është anomalisht e ulët.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të hollësishëm të veprimeve të kryera, gjatë procedurës së prokurimit, duke u ballafaquar me dokumentat e tenderit, si dhe detyrimet ligjore për prokurimet publike, është arritur në konkluzionin, se oferta e paraqitur dhe e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik nga operatori ekonomik, është e pranueshme dhe e vlefshme të kualifikohet, mbasi është në përputhje me kërkesat e ligjit të prokurimeve, plotëson kërkesat administrativo-ligjore dhe specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit të Autoritetit tonë Kontraktor.

**Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e paraqitur e vlefshme nuk është anomalisht e ulët në bazë të nenit 93, Kreu XI të Ligjit nr.162, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”**

**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përputhje me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, vendosi të bëjë vlerësimin dhe klasifikimin e ofertës të vlefshme të shoqërisë, si më poshtë:**

- Operatori ekonomik **“SI.SI-AL” sh.p.k** me ofertë ekonomike prej **5,779,680** (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH, kualifikohet.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e Operatorit Ekonomik **“SI.SI-AL” sh.p.k** me adresë Tiranë, KASHAR Autostrada Tiranë-Durrës, km 4, Përballë BMW-së., me vlerë **5,779,680 (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH** pas vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave është identifikuar si oferta e vlefshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Tirana Parking, me adresë: Rruga “Ali Begeja”, Nd.16, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditësh nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Ka Pasur

Vendimi Nr.574/2021

